

U R D H Ë R
Datë 21.5.1999

**PËR PAJISJEN E SUBJEKTEVE ME LEJE DHE AUTORIZIME PËR TREGTIMIN E
NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 4 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i cili përcakton se “Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me leje dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e tyre quhet e paligjshme”.

U R D H Ë R O J M Ë:

1. Të gjitha subjektet që aktualisht ushtrojnë veprimtari në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, duhet të pajisen me lejet e tregtimit ose autorizimet në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8450, datë 24.2.1999.

2. Subjektet e interesuara për të ushtruar këtë veprimtari, të paraqesin kërkesën për t’u pajisur me lejet dhe autorizimet përkatëse, në zbatim të këtij ligji, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Hidrokarbureve.

3. Duke filluar nga data 1 korrik 1999, asnjë subjekt nuk mund të vazhdojë ushtrimin e kësaj veprimtarie, nëse nuk plotësohen kërkesat e këtij urdhri, në të kundërt do të zbatohen sanksionet ligjore përkatëse.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrin të gjitha masat e duhura për zbatimin e këtij Urdhri.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI MINISTRI
Anastas Angjeli Ylli Bufi

Nr.3347 Prot.
Datë 21.5.1999